



REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION	
№/B. Nr. 3-1184	DALJE Data/Datë 30/05/2015
Proshpimit/Proshpimit Proshpimit	

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit - Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Dt. 30/05/2015
Nr. 3-1184

Komisioni i MASHTI për shqyrtimin e kërkesave për licencim dhe rilicencim të IPAAP, në bazë të dispozitave të nenit 46 të Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, në mbështetje të Udhëzimit administrativ nr. 17/2016 - Kriteret për licencimin dhe rilicencimin e institucioneve arsimore private parauniversitare, të mesme të larta profesionale dhe institucioneve aftësuese profesionale si dhe kërkesës së institucionit “Austrian Schule”, rr. “Gjilani” në Prishtinë me nr. prot.3-1184 datës 28.03.2025, nxjerr:

VENDIM

1. LICENCOHET Shkolla Profesionale “Austrian Schule”, rr. “Gjilani” në Prishtinë, për ushtrimin e veprimtarisë aftësuese për nivelet III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK për programet:
 - 1.1. “Bashkëpunëtor Profesional i Infermierisë, Niveli III (tre) dhe IV(katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”.
 - 1.2. “Teknik Dentar, Niveli III (tre) dhe IV (katër) sipas KKK, lloji: Kualifikimet Kombëtare të Kombinuara (C) me 180 kredi të AAP”.
2. Veprimtaria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi ushtrohet në përputhje me certifikatën e lëshuar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve dhe legjislacioni në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Në bazë të dispozitave të lartcekura, Komisioni i veçantë i MASHTI-t, shqyrtoi kërkesën për licencim me nr. 3-1184 të datës: 28.03.2025.

Komisioni në përputhje me legjislacionin në fuqi administroi dokumentacionin e ofruar, zhvilloi procedurat administrative, vizitoi institucionin dhe në bazë të Raportit, komisioni konstatoi se, IAP "Austrian Schule", rr. "Gjilani" në Prishtinë, i ka plotësuar kushtet dhe kriteret bazë për zhvillimin dhe ofrimin e veprimtarisë për aftësim profesional, të përcaktuara me Udhëzimin administrativ nr. 17/2016, prandaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të ushtroj ankesë në Komisionin për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të vendimit.

Vendimi u dërgohet:

1. IAP "Austrian Schule" në Prishtinë;
2. Kabinetit të Ministrit;
3. Zyrës së Sekretarit të përgjithshëm të MASHTI;
4. Divizionit për arsimin privat parauniversitar;
5. Inspektoratit të arsimit në MASHTI;
6. Arkivit të MASHTI.

Valbona Fetiu-Mjeku, kryesuesë e komisionit

